



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

| | |
|------------------------|--|
| DATE/A: | 08.04.2026 |
| REFERENC-Ë: | 25/6885/MMPH |
| PËR/ZA/TO: | "SVEA" Sh.p.k. Deçan |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Bajram Kafexholli, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPH |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim |

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/193/12/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "SVEA" Sh.p.k. Deçan, për Pëlqim Mjedisor për Fabrikën e ambalazhimit të ujit të pijshëm, prodhimin e ujit të gazuar dhe pijeve freskuese në Z.K. Isniq, Deçan.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "SVEA" Sh.p.k. Deçan, pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për fabrikën e ambalazhimit të ujit të pijshëm, prodhimin e ujit të gazuar dhe pijeve freskuese në ngastrën kadastrale P-70511038-00515-1 në Z.K. Isniq, Deçan, nën kushtet si vijon, nën kushtet si vijon:

- Të zbatohen obligimet dhe përgjegjësitë të cilat dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
- Të zbatohen obligimet dhe përgjegjësitë të cilat dalin nga Ligji për Ujëra
- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e ujit të pijshëm dhe ambalazhimin e ujit nëntokësorë, si dhe të tëra sipërfaqet funksionale;

Faqe 2 nga 5



- Të vendoset sistemi për trajtimin e ujërave industriale dhe ujërave atmosferike të cilat krijohen në sipërfaqet operationale gjatë të reshurave (sedimentuesit dhe separatori për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga uji), para shkarkimit të tyre;
- Të vendosen pajimet adekuate për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe lëngta;
- Bazuar në Ligjin e Ujërave Nr. 04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;

Aplikuesi përveq kushteve të lartë cekura duhet t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

Pëlqimi Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar që pas pajisjes me Pëlqim Mjedisor të aplikoj për Lejet ujore dhe Lejen Mjedisore.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumantacionit përcjellës të dorëzuar për kompaninë "SVEA" Sh.p.k. Deçan, për fabrikën e ambalazhimit të ujit të pijshëm, prodhimin e ujit të gazuar dhe pijeve freskuese në ngastrën kadastrale P-70511038-00515-1 në Z.K. Isniq, Deçan, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerr Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Lejet ujore dhe Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM Nr. 08/L-181.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



Vërejtje: Afati për shqyrtimin e lëndës është tejkaluar për shkak të kompleksitetit të lëndës dhe zëvendësimit të Sekretarit të MMPH-së.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/193/ZSP/ /26 datë: 08.04.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Deçanit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
7. Divizionit për Komunikim me Publikun
8. Arkivit të MMPH

Bajram Kafexholli

U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPH



2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit,subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

